

BASHKIA TIRANË

QËNDRA KOMUNITARE SHKOZË TIRANË

Tiranë, më _____.____.2025

PROÇES – VERBAL Nr.1

“Për Hartimin, Argumentimin dhe Miratimin e Kriteve të Veçanta për Kualifikim dhe Specifikimeve Teknike, që lidhen me kapacitetin ekonomik dhe financiar, kapacitetin teknik të procedurës së prokurimit me objekt:

Blerje furgon (mikrobus)

Per vitin 2025

I mbajtur sot më datë _____, në Qendren Komunitare shkoze, Bashkia Tiranë nga Njësia e Prokurimit e ngritur me Urdhërin Nr.prot 1 data 06.01.2025 për realizimin e prokurimit me procedurë “Procedurë e Hapur e thjeshtuar” me objekt: “Blerje furgoni (mikrobus) me fond limit 2,083,333 lek pa tvsh(dy million e tetedhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre)lekë pa tvsh.

- 1. ” Bazuar në VKB 57 date 24.07.2025 për disa ndryshime në miratimin e programit buxhetor afatmesem 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tirane për vitin 2025.

- 2. Bazuar në shkresën Nr. 27405 prot datë. 05.08.2025 dhe e protokolluar nga institucioni jone me nr.300 prot. 06.08.2025.

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Blerje furgoni (mikrobus)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Minibus-- 34114400-3

Numri i referencës së procedures /Lotit:) Ref-60098-09-02-2025

VLERA E FONDIT LIMIT:

2,083,333 (dy million e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) **lek pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Qendra Komunitare Shkozë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76, 82 dhe 83 të LPP, nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76” Kriteret detyrues për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, Nr. 285, datë 19.5.2021 për miratimin e rregullave të Prokurimit

Publik (ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021 ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 1.8.2024 ndryshuar.

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”,

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron, për 3 (tre) vitet e fundit financiar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, përkatësisht fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë referuar nenin 43 pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të balanceve të viteve 2022, 2023 dhe 2024 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivi. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në nenin 43 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenit 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mesipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor para lidhjes së marrëveshjes kuadër.

3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

1.Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ose,

b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 1, të ligjit nr 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 40, pika 4, vendimit nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të

Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Vlera është përlogaritur në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat cilësie ISO 9001:2015(Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) (te vlefshme) ose ekuivalente të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një specialist/ teknik të specializuar/ diplomuar në inxhinierinë mekanike për mjetet e transportit.

Për të vërtetuar kriteret e mësipërme, operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat përkatëse të punonjësit si dhe kontratë të vlefshme pune të lidhur midis operatorit ekonomik dhe punonjësit.

Punonjësit e sipërpërmendur duhet të kenë aktualisht një marrëdhënie pune me operatorin ekonomik prej jo më pak se 3(tre) muaj, e vërtetuar kjo me formularët E-sig të listës së pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore të 3 muajve të fundit, të konfirmuar pranë organeve tatimore.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë foto (para, mbrapa, majtas, djathtas dhe brenda) të mallrave objekti i prokurimit, bashkangjitur karakteristikat teknike të çdo artikulli të kërkuar në shtojcën 5 DST.

2.3.4. Fusha e veprimtarisë së operatorit ekonomik ofertues në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit duhet të përputhet me objektin e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Mjet me specifikime si më poshtë :

Specifikimi i Materialeve:

Mjeti mikrobush 14 vendesh (furgon) me specifikime si më poshtë ;

1- Kategoria: - minibus

- 2- Viti i prodhimit : - 2010 e siper
- 3- Lloji i Karburantit: - Naftë
- 4- Fuqia e motorit : - 100 kë (140 kf).
- 5- Ajrimi: - kondicioner normal
- 6- Kutia e shpejtësisë: - me 6 marsha me ndrim manual/automatik
- 7- Numuri i vëndeve : - 14+ 1.
- 8- Siguria: - Airbag për shoferin dhe pasagjerin, ABS, ASR.
- 9- Numuri i akseve aktivë : - 2 (dy) akse
- 10- Goma: -tek/dopio gome

11- Jo me shume se: - 180000- 220000 Km.
Euro 4 (euro 5)

- Mjeti duhet të jetë në gjendje shumë të mire pune dhe të mos ketë asnjë defekt teknik si demtim te tubove, mos te kete rrjedhje vaji ne motor apo rrjedhje te tjera.
- Mjeti te mos jete i demtuar, te mos kete gervishtje apo demtime , i plasaritur ose i ndryshkur.
- Xhamat e gabines te mos jene te demtuar.
- Sistemi elektrik te jete funksional dhe me pjeset e tjera ku te funksinojne te gjitha pajisjet elektrike.
- Mjeti duhet te jete i pajisur me dokumentacionin e meposhtem
 - Certifikatë pronësie,
 - Lejë qarkullimi e vlefshme
 - Certifikatë e kontrollit teknik e vlefshme
 - Polica e sigurimit e vlefshme
 - Taksa vjetore e mjeteve e vlefshme

Specifikimet teknike janë hartuar në terma funksional sipas funksionalitetit që do të kenë në përdorim këto automjete, duke u mbështetur në kërkesat e sistemit të Autoritetit Kontraktor, bazuar në fondet e akorduara nga buxheti i shtetit për zërin e investimeve për blerje mikrobuses. Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala “ose ekuivalent” e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.

Këto specifikime teknike përcaktojnë karakteristikat e mallrave që prokurohen, duke i përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë sipas objektit të prokurimit, të cilat krijojnë kushte për konkurrin të paanshëm dhe të hapur për të gjithë operatorët ekonomik, duke mundësuar një trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët e interesuar. Këto specifikime teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që krijojnë mundësinë e konkurrencës dhe trajtim të barabartë nga marka të ndryshme të prodhimit të automjeteve për të gjithë Operatorët Ekonomikë e interesuar.

Kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke shërbyer për autoritetin kontraktor për njohjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Argumentim: Përlllogaritja e fondit limit është bazuar në pikën b, të nenit 76 të vendimit nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” duke u bazuar në studimin e tregut, në mesataren e cmimive të mara nga 3 (tre) ofertat.

Fondi limit është 2,083,333 (dy million e tetedhjetë e tre mije e treqind e tridhjetë e tre) **lek pa tvsh.**

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: 15.09.2025, ora 11.00; Vendi: www.app.gov.al,